



## Legalizimi i çertifikatave të Republikës së Kosovës

Legalizimi i shërben synimit për përdorim të çertifikatave kosovare të gjendjes civile në Gjermani brenda qarkullimit të tyre mes shtetesh. Për të shmangur shpenzimet eventuale të panevojshme, rekomandohet që fillimisht të siguroheni nga institucioni përkatës brenda Gjermanisë, nëse kërkohet domosdoshmërisht legalizimi i çertifikatave.

### Cilat çertifikata mund të legalizohen?

Mund të legalizohen vetëm çertifikatat e gjendjes civile, të cilat iu referohen gjendjeve civile (d.t.th. lindjeve, lidhjeve të martesave dhe vdekjeve) që kanë ndodhur pas datës 18.02.2013 (Lansimi i Regjistrimit Qendror i të Dhënave Personale të Republikës së Kosovës).

Për çertifikata të tjera zyrtare nga Republika e Kosovës nuk ka parakushte për legalizim. Kjo vlen për çertifikatat e përgatitura nga noterët kosovarë dhe si vërtetimet zyrtare si psh. vërtetimet e gjendjes martesore, të vendbanimit, të shtetësisë dhe vërtetimet nga arkivi. Për këtë arsye, me miratim të Ministrisë Federale për Punë të Jashtme këto çertifikata nuk legalizohen. Në raste të domosdoshme mund të bëhet një verifikim i çertifikatave (shih fletëinformacionin e veçantë). Legalizimi i aktvendimeve të shkurorëzimit nuk është i mundur. Poashtu edhe çertifikatat e martesës, për martesat të cilat në ndërkohë janë zgjidhur, nuk vulojnë me vull të verifikimit nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës dhe për këtë arsye nuk mund të legalizohen.

Parakusht për legalizimin përfundimtar të një çertifikate nga ana e ambasadës është vërtetimi paraprak me vull të verifikimit nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës:

Ministria e Punëve të Brendshme Agjencia e Regjistrimit Civil  
Rruga: "Luan Haradinaj" p.n.  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Zyra për Komunikim Publik  
Tel: + 381 (0) 38 200 19 545  
E-Mail: [zip-mpb@rks-gov.net](mailto:zip-mpb@rks-gov.net)

Gjuhët e korrespondencës janë: gjuha shqipe, serbe dhe angleze.



## Si bëhet legalizimi?

Certifikatat origjinale, të vërtetuara (vulosura) aktualisht me vulën e verifikimit nga Ministria e Punëve të Brendshme kosovare jo më të vjetër se 6 muaj, munden tani të dorëzohen në Ambasadën Gjermane në Prishtinë për legalizim vetëm me shkrim, një paraqitje personale për këtë çështje tani është e pamundur për arsye të kufizimeve ekzistuese lidhur me pandeminë Covid-19. Ju lusim që dokumentet ne vijim t'i dërgoni me postë në ambasadë ose t'i dorëzoni në një zarf të mbyllur tek porta (hyrja kryesore) e ambasadës:

- Formularin e plotësuar komplet dhe të nënshkruar nga poseduesi i certifikatës “Kërkesa për legalizim të certifikatës”
- Certifikata e legalizuar/certifikatat e legalizuara dhe të vulosura aktualisht me vulën e verifikimit të Ministrisë kosovare të Punëve të Brendshme
- Kopjen e letërnjoftimit ose pasaportës së vlefshme të poseduseit të certifikatave.

Tarifa për legalizim është 25 euro për çdo certifikatë të gjendjes civile duke shtuar edhe 3 euro për shërbim postar me rekomandë për kthim të certifikatës në një adresë në Kosovë. Nëqoftëse certifikata e legalizuar duhet të dërgohet në një adresë jashtë Kosovës, atëherë kërkesës duhet t'i bashkangjitet një zarf i DHL-së i adresuar paraprakisht dhe i parapaguar. Për adresim dhe parapagim të saktë përgjegjësinë e bart vetë aplikuesi.

**Udhëzim me rëndësi: Pagesa e tarifës për legalizim bëhet vetëm përmes transferit bankar. Ju lusim që kërkesës me shkrim të mos i bashkangjisni para ose qeqe.** Pas pranimit dhe verifikimit të dokumenteve tuaja, ju do të pranoni nga ambasada një email me të dhënat e bankës, shumën e tarifës që duhet paguar dhe numrin e regjistrimit, të cilin duhet ta cekni në transfer. Ju lusim që të mos bëni transfer para se të kërkohet kjo nga Ju, sepse pagesat pa numer të regjistrimit nuk mund të përpunohen.

## Si do ta marr unë certifikatën e legalizuar?

Kthimi i certifikatës së legalizuar zakonisht bëhet përmes postës, marrja personale tani nuk është e mundur për shkak të kufizimeve aktuale për raste të pandemisë Covid-19. Certifikata e legalizuar do të dërgohet në adresën e dhënë nga ju 2-3 javë pas pranimit të pagesës së tarifës në xhirollogarinë tonë. Sipas dëshirës certifikatat e legalizuara, të cilat janë kërkuar për një rast të hapur të vizave, mund të dorëzohen nga ana jonë drejtpërdrejt tek sektori i vizave. Ju lusim që në këtë rast ta shënoni numrin e kërkesës suaj të vizës ose ta bashkangjisni një kopje të fletpagesës suaj të vizës, të cilën e keni marrë kur keni aplikuar për vizë. Në këtë rast certifikatën në original do ta merrni më vonë së bashku me vendimin për kërkesën tuaj për vizë nga sektori i vizave. Një dorëzim direkt nga ana jonë në sektorin e vizave nuk është i mundur në rastet kur ende nuk është paraqitur kërkesa për vizë.

**Këto të dhëna jepen në bazë të informatave, të cilat i ka pasur në dispozicion Ambasada Gjermane në Prishtinë në kohën e publikimit. Nuk merret përgjegjësi për plotësinë, saktësinë dhe aktualitetin e informatave.**

Termine nur nach vorheriger Vereinbarung  
unter [www.pristina.diplo.de](http://www.pristina.diplo.de)